



AVOKATI I POPULLIT



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
AVOKATI I POPULLIT  
Seksioni i Veçantë

Adresa: Bulevardi: "Zhan D'Ark" Nr.2  
Tiranë, Shqipëri

Tel/Fax: +355 4 2380 300/315  
E-mail: [ap@avokatipopullit.gov.al](mailto:ap@avokatipopullit.gov.al)  
[www.avokatipopullit.gov.al](http://www.avokatipopullit.gov.al)

Nr. Prot.  
Nr. Dok.201900662/7

Tiranë 11/11/2019

**Lënda:** Rekomandim për dhënien zgjidhje të problematikës së paraqitur në ankesën e shtetasit B.J

**Drejtuar:** **MINISTRISË SË BRENDSHME**  
**Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile**  
Drejtorit z.Bledar Doracaj

Tiranë

*I nderuar zoti Doracaj,*

Rikujtojmë se në Institucionin e Avokatit të Popullit është regjistruar ankesa e shtetasit B.J, i cili është ankuar për problematikën në lidhje me pasqyrimin e vendlindjes së tij në dokumentet e identitetit.

Z.J referon se ka ardhur nga Çamëria si emigrant në vitin 1944 dhe është regjistruar fillimisht në Cërrik-Elbasan, por certifikata e tij e lindjes është ende në Igumenicë.

Fillimisht shtetasi B.J i është drejtuar me kërkesë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, me objekt vërtetimin e faktit juridik të vendlindjes, Arpicë Greqi. Kjo gjykatë me vendimin nr.399, datë 09.03.2009 ka vendosur pranimin e kërkesës së kërkuarit B.J dhe vërtetimin e faktit juridik të vendlindjes, se kërkuari B.J ka lindur në Arpicë Greqi. Ky vendim ka marrë formë të prerë në datë 10.04.2009.

Por më pas ky shtetas ka hasur probleme për kalimin e kufirit grek, për arsye se vendi Arpicë nuk njihet në listën e toponimeve të shtetit grek. Aktualisht ky shtetas kërkon përcaktimin në anglisht të vendlindjes, sipas listës së toponimeve të shtetit grek.

Zyra e Gjendjes Civile nr.1 Bashkia Fier i ka kthyer përgjigje se: "Sipas Udhëzimit nr.7734/4, datë 23.10.2014 "Për mënyrën e plotësimit të Rubrikës "vendlindja" në regjistrin kombëtar të gjendjes civile të shtetasve", nën rubrika "vendlindja sipas toponimit do të pasqyrohet vetëm për plotësimin e certifikatave "Për përdorim nga autoritetet e huaja" për shtetasit shqiptarë të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë.

*Me vendim gjykate është ndryshuar vendlindja nga Arpicë Marglliç në Arpicë Greqi. Në listën e toponimeve sipas katalogut që ka paraqitur shteti grek pranë OKB-së për emrat zyrtarë të romanizuar, Arpicë nuk ekziston. Zyra e Gjendjes Civile nuk mund ta ndryshojë sipas kësaj liste. Për pretendimin se Arpicë sot njihet Perdika shtetasi duhet t'i drejtohet Gjykatës.”*

Zoti J i është drejtuar Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier përsëri me objekt vërtetimin e faktit juridik të vendlindjes. Por duke qenë se kërkesa e tij është paraqitur me të meta dhe nuk janë kushtet kur kërkuesi njoftohet për plotësimin e tyre brenda një afati të vendosur nga gjykata, pasi në rastin konkret nuk mund t'i drejtohet gjykatës me kërkesë sipas objektit të parashtruar, duke qenë se nuk pretendon vërtetimin e ndonjë fakti juridik, por pretendon ndryshimin e të dhënave në aktet e Zyrës së Gjendjes Civile, për fakte të ndodhura më pas, gjykata me vendimin nr.62-2019-2300 (556), datë 26.04.2019 ka vendosur kthimin e kërkesës dhe akteve bashkëlidhur kërkuetit B.J në çështjen civile me nr.21250-01033-62-2019 (1076) Regj.Them.

Pas paraqitjes në institucionin tonë të zotit B.J, fillimisht ju jemi drejtuar me shkresën nr.K2/B8-2 prot., datë 31.05.2019 ku kemi kërkuar orientim për zgjidhjen e problematikës lidhur me vendlindjen e shtetasit.

Në kthim përgjigjen tuaj nr.81/1, datë 18.06.2019 keni sugjeruar se nëpërmjet Ministrisë për Evropën dhe Punët e Jashtme t'i kërkohej sqarime palës greke, në kontekst të problematikës për këtë shtetas, kur vendlindja Arpicë nuk përfshihet në marrëveshjen e toponimeve.

Në vijim nga ana jonë u paraqit ky rast në Ministrinë për Evropën dhe Punët e Jashtme. Kjo ministri na informon se emri Arpicë është ndërruar në Perdika dhe kjo pasqyrohet në Fletoren Zyrtare të Shtetit Grek (fletorja zyrtare greke nr.76, 2 maj 1927). Gjithashtu, sipas faqes zyrtare të Shërbimit Gjeografik të Ushtrisë Greke, zona në fjalë përshkruhet gjithashtu si Perdika, GRC.

Në vijim ministria sqaron se për çështjen në fjalë, në bazë të marrëveshjes për toponimet mes Shqipërisë dhe Greqisë të vitit 2014, për shtetas shqiptarë të lindur në Greqi (dhe anasjelltas atyre grekë të lindur në Shqipëri) do të shërbejë katalogu zyrtar që secili vend ka dorëzuar në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare, veçanërisht duke iu referuar standardeve të ICAO.

Në bazë të zbatimit të kësaj marrëveshjeje (udhëzimi përkatës i Ministrisë sonë të Brendshme Drejtorisë së Përgjithshme të Gjendjes Civile), për raste të tilla si ai i z.B.J (shtetas shqiptarë të lindur jashtë territorit të Republikës së Shqipërisë), pajisen me pasaportë ku shënohen vetëm inicialet e shtetit ku kanë lindur, në këtë rast GRC.

Bashkëlidhur do të gjeni praktikën e plotë të përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, ku përfshihet edhe Botimi i Fletores së Qeverisë Greke nr.76, datë 2 maj 1927, dhe konfirmohet se emri Arpicë ndërrohet në Perdika (pika A.2).

Në përfundim, duke vlerësuar bashkëpunimin dhe korrektesën e treguar nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme e cila përcolli dokumentacionin zyrtar, si dhe duke i dhënë rëndësinë e duhur të drejtës së qytetarit për t'u pajisur me dokumente të vlefshme të cilat të garantojnë lëvizjen e tij të lirë dhe të mos paraqesin pengesa në të ardhmen, është e nevojshme që Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile të veprojë në mënyrë të arsyeshme dhe të drejtë.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, dhe në përputhje me pikën b të nenit 21 të ligjit nr.8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar:

### **REKOMANDOJMË:**

Marrjen e masave për zgjidhjen sa më parë të çështjes së zotit B.J, mbështetur në dokumentacionin zyrtar të përcjellë nga Ministria për Evropën dhe Punët e Jashtme, me qëllim reflektimin e të dhënave të dërguara në dokumentet e gjendjes civile në përputhje me vendimin nr.332, datë 17.03.2010 të Këshillit të Ministrave “Për përcaktimin e formës, elementeve përbërëse, mënyrës së mbajtjes e afatit të përdorimit të dokumenteve bazë, që mbahen dhe lëshohen nga shërbimi i gjendjes civile”, të ndryshuar.

Në përputhje me nenin 22, të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar lutemi na vini në dijeni për qëndrimin tuaj, ndaj këtij rekomandimi.

*Duke besuar në bashkëpunimin dhe mirëkuptimin tuaj,*

**KOMISIONERI**

**Ermonela Ruspi**